

**MARRËVESHJE NDËRMJET REPUBLIKËS SË TURQISË DHE  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI SHMANGIEN E TATIMIT TË  
DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË  
LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT**

**REPUBLIKA E TURQISË**

**DHE**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**ME DËSHIRË për të përmyllur Marrëveshjen e shmangies së tatimeve të  
dyfishta dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi të  
ardhurat**

**KANË RËNË DAKORD PËR ÇËSHTJET MË POSHTË:**

**NENI 1**  
**PERSONAT E PËRFSHIRË**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj personave që janë rezident të njërit apo të të dy Shteteve Kontraktuese.

**NENI 2**  
**TATIMET E PËRFSHIRA**

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj tatimeve mbi të ardhurat në emër të një Shteti Kontraktues apo të nënndarjeve të tij politike apo autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato vilen.

2. Do të konsiderohen si tatime mbi të ardhurat, të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale apo në elemente të të ardhurave përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pronës së tundshme ose patundshme si dhe tatimet mbi shumat totale të rrogave dhe pagesave të paguara nga ndërmarrjet.

3. Tatimet e ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Marrëveshja janë në veçanti:

a) në Turqi:

- (i) Tatimi mbi të ardhurat; dhe
- (ii) Tatim i korporatave  
(i referuar më tutje si "Tatimi Turk")

b) në Kosovë:

- (i) Tatimi mbi të ardhurat personale; dhe
- (ii) Tatimi mbi të ardhurat e korporatave  
(i referuar më tutje si "Tatimi Kosovar")

4. Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu ndaj çdo tatimi të njëjtë apo në thelb të ngjashëm të vendosur pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes si shtojcë, apo në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve

Kontraktuese do të njoftojnë njëri tjetrin për çdo ndryshim të rëndësishëm që bëhet në ligjet e tyre tatimore përkatëse.

### NENI 3

#### PËRKUFIZIME TË PËRGJITHSME

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:
  - a) termi "Turqia" nënkupton territorin turk përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën mbi të, dhe gjithashtu zonat detare mbi të cilat ajo ushtron juridiksionin dhe të drejta sovrane për qëllime hulumtimi, shfrytëzimi dhe konservimi të resurseve natyrale në pajtim me të drejtat ndërkombëtare;
  - b) termi "Kosova" nënkupton Republikën e Kosovës përfshirë të gjithë territorin e Kosovës, hapësirën mbi të për të cilën ajo ushtron juridiksionin ose të drejtën sovrane për qëllime shfrytëzimi, hulumtimi dhe konservimi të resurseve natyrale në pajtim me të drejtat ndërkombëtare;
  - c) termat "Shtetet Kontraktuese" dhe "Shtet tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Turqinë ose Kosovën varësisht nga konteksti;
  - d) termi "tatim" nënkupton tatimet e përfshira në Nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje;
  - e) termi "person" përfshin individin, ndërmarrjen ose grup të personave;
  - f) termi "ndërmarrje" nënkupton trup i ndërmarrjes ose iniciativë që trajtohet si trup i ndërmarrjes për qëllime të tatimit;
  - g) termi "zyra udhëheqëse" nënkupton zyre e regjistruar sipas Kodit Tregtar Turk ose Ligjit të Kosovës mbi Organizatat Tregtare ose ligje të ngjashme pasardhëse të këtyre ligjeve;
  - h) termat "ndërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "ndërmarrje e ndonjë Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë respektivisht një ndërmarrje të udhëhequr nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje të udhëhequr nga rezidenti i një Shteti tjetër Kontraktues";

- i) termi "komunikacioni ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije, aeroplan ose automjet rrugorë i cili operohet nga një ndërmarrje e Shtetit Kontraktues përveç kur anija, aeroplani ose automjeti rrugorë operohet vetëm nga vende të tjera të Shteteve Kontraktuese;
- j) termi "autoriteti kompetent" nënkupton:
  - (i) në lidhje me Turqinë, Ministri i Financave ose përfaqësuesi i autorizuar nga Ministri; dhe
  - (ii) në lidhje me Kosovën, Ministri i Financave ose përfaqësuesi i autorizuar nga Ministri;
- k) termi "kombëtarë", në lidhje me Shtetin Kontraktues, nënkupton:
  - (i) çdo individ që zotëron kombësinë ose shtetësinë e atij Shteti Kontraktues; dhe
  - (ii) çdo person juridik, ortakëri ose organizatë që gëzon statusin si i tillë nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues.

2. Sa i përket zbatimit të marrëveshjes në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë në atë kohë në legjislacionin e atij Shteti për qëllime të tatimeve ndaj të cilave zbatohet Marrëveshja; çdo kuptim i dhënë në ligjet tatimore në fuqi të atij Shteti do të ketë përparësi ndaj kuptimit që i jepet termit në ligje të tjera të atij Shteti.

#### **NENI 4** **REZIDENTI**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi "rezident i Shtetit Kontraktues" nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij Shteti i nënshtrohet tatimeve për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, zyrës udhëheqëse ligjore, vendit të menaxhimit ose çdo kriteri tjetër të natyrës së ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë Shtet ose çdo nënndarje politike ose autoritet lokal atje. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë Shtet lidhur vetëm me të ardhurat nga burime në atë Shtet.
2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si më poshtë:

- a) ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; nëse ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy Shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);
- b) nëse Shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetike nuk mund të përcaktohet, ose nëse ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin Shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit në të cilin qëndron zakonisht;
- c) nëse ai qëndron zakonisht në të dy Shtetet apo në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit nënshtetas i të cilit është ai;
- d) nëse ai është nënshtetas i që të dyja shteteve apo asnjërës prej tyre, atëherë autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person, jo-individ, është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit në të cilin ndodhet zyra udhëheqëse ligjore.

## **NENI 5**

### **SELIA E PËRHERËSHME**

- 1. Për qëllime të kësaj Marrëveshje, termi “Selia e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i ndërmarrjes.
- 2. Termi “Selia e përhershme” përfshin në veçanti:
  - a) një vend menaxhimi;
  - b) një degë;
  - c) një zyrë;
  - d) një fabrikë;

- e) një punishte, dhe
- f) një minierë, një pus naftë ose gaz, apo çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore;

3. Një shesh ndërtimi, projekt ndërtimi ose instalimi përbëjnë një Seli të përhershme vetëm nëse sheshi ose projekti zgjatën më shumë se 12 muaj;

4. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij Neni, termi "Seli e përhershme" nuk do të përfshijë:

- a) përdorimin e objekteve vetëm për qëllime deponimi, shpërndarje apo ekspozimi të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;
- b) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime deponimi, ekspozimi apo shpërndarjeje;
- c) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim përpunimi nga një ndërmarrje tjetër;
- d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave apo për mbledhje informacioni për ndërmarrjen;
- e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit të çdo aktiviteti me karakter përgatitor ose ndihmës për ndërmarrjen.
- f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nën-paragrafët a) deri e), me kusht që i tërë aktiviteti i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person -i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 6- vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një ndërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues, kjo ndërmarrje do të konsiderohet se ka një Seli të përhershme në Shtetin e përmendur në fillim lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, nëse ky person ka dhe zakonisht ushtron në Shtetin e përmendur në fillim një autoritet për të përmbyllur kontrata në emër të ndërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në

paragrafin 4 që, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk do ta bënin këtë vend fiks biznesi një Seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet se ka një Seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm për faktin se ushtron biznes në atë Shtet nëpërmjet një ndërmjetësuesi, agjenti komisionar të përgjithshëm apo çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë në kuadrin e zakonshëm të biznesit të tyre.

7. Fakti që një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon apo kontrollohet nga një kompani që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, apo që ushtron biznes në atë Shtet tjetër (qoftë nëpërmjet një Selie të përhershme apo ndryshe), nuk përbën arsye të mjaftueshme për ta konsideruar njërin kompani Seli të përhershme të tjetrës.

## NENI 6

### TË ARDHURAT NGA PASURIA E PATUNDSHME

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e patundshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia apo pyjet) të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në Shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e patundshme” do të ketë kuptimin që i është dhënë në legjislacionin e Shtetit Kontraktues në të cilin është vendosur pasuria në fjalë. Në çdo rast termi do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së patundshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi (përfshirë rritjen dhe kultivim e peshqve) dhe në pyje, të drejtat ndaj të cilave aplikohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronësinë mbi tokën, uzufukti i pasurive të patundshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse apo të ndryshueshme që jepen si shpërblim për shfrytëzimin, apo të drejtën e shfrytëzimit, të zonave dhe burimeve minerare dhe burimeve të tjera natyrore. Anijet dhe aeroplanët nuk do të konsiderohen pasuri e patundshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave nga përdorimi direkt, nga qiradhënia, apo përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e patundshme të një ndërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e patundshme të përdorura për ushtrimin e shërbimeve të pavarura personale.

## **NENI 7**

### **FITIMET BIZNESORE**

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet përveç kur ndërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një Selie të përhershme të vendosur aty. Nëse ndërmarrja ushtron biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në Shtetin tjetër por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj Selie të përhershme.

2. Subjekt i dispozitave të paragrafit 3 kur një ndërmarrje e Shtetit Kontraktues ushtron biznesin në një Shtet tjetër Kontraktues përmes një Selie të përhershme të vendosur atje, në secilin Shtet Kontraktues do t'i atribuohen fitimet Selisë së përhershme që mund të pritet t'i bëjnë nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e pavarur e angazhuar në veprimtari të njëjtë ose të ngjashme nën kondita të njëjta ose të ngjashme dhe duke punuar plotësisht e pavarur me ndërmarrjen e cila është pjesë e Selisë së përhershme.

3. Në përcaktimin e fitimeve të Selive të përhershme do të lejohet zbritja në shpenzime të cilat bëhen për arsye të Selisë së përhershme përfshirë dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të bëra, qoftë në Shtetin ku është vendosur Selia e përhershme ose tjetërkund.

4. As një fitim nuk do t'i atribuohet Selisë së përhershme për arsye të blerjes së mallrave nga ajo Seli e përhershme për ndërmarrje.



5. Kur fitimet përfshijnë lloje të të ardhurave që trajtohen veçmas në Nene të tjera të kësaj Marrëveshje, atëherë dispozitat e atyre Neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij Neni.

## **NENI 8**

### **TRANSPORTI DETAR, AJROR DHE TOKËSOR**

1. Fitimet e ndërmarrjeve të Shteteve Kontraktuese nga veprimtaria e anijeve ose aeroplanëve në komunikacionin ndërkombëtar do të tatóhen vetëm në Shtetin Kontraktues.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij Neni do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një marrëveshje, një biznes të përbashkët apo në një agjenci transporti ndërkombëtar.

## **NENI 9**

### **NDËRMARRJET E LIDHURA**

#### **1. Kur**

a) një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtit persona marrin pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kur kushtet e vendosura ose të diktuar midis dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra prej ndërmarrjeve, por që për shkak të këtyre kushteve nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrje dhe të tatóhet normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti – dhe i taton normalisht – fitime për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është ngarkuar me tatim në atë Shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga ndërmarrja e Shtetit të përmendur në fillim nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të ishin ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë ai Shtet tjetër do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit të ngarkuar mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi do t'i kushtohet vëmendje edhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese në rast nevojë do të konsultohen me njëra tjetrën.

## **NENI 10**

### **DIVIDENDAT**

1. Dividendat e paguara nga një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në atë Shtet tjetër.
2. Megjithatë, këta dividendë mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është kompania që bënë pagesën e dividendëve dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë:
  - a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve nëse pronari përfitues është një kompani (tjetër nga një ortakëri) që zotëron direkt të paktën 25 për qind të kapitalit të kompanisë që bënë pagesën e dividendëve;
  - b) 15 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk do të ndikoj në tatimin e ndërmarrjes respektivisht në fitimin prej të cilave janë paguar dividendat.

3. Termi “dividendë” në kuptimin e përdorur në këtë Nen nënkupton të ardhurat nga aksionet, përfshirë aksionet ose të drejtat “jouissance”,

aksionet e minierave, aksionet e themelimit, apo të drejta të tjera që nuk përbëjnë kërkesa borxhi, pjesëmarrjen në fitime, dhe të ardhurat nga të drejta të tjera të korporatave që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit rezidente e të cilit është kompania që bën shpërndarjen dhe të ardhurat nga fonde të investuara dhe truste.

4. Fitimet e ndërmarrjes të një Shteti Kontraktues e cila ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues përmes Selisë të përhershme të vendosur atje, pasi që është tatuar sipas Nenit 7, duhet tatuar për shumën e mbetur në Shtetin Kontraktues ku Selia e përhershme ndodhet në pajtim me paragrafin 2 të këtij Neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të aplikohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve, nëpërmjet një Selie të përhershme të vendosur aty dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me këtë Seli të përhershme. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 ose Nenit 14, varësisht nga rasti.

6. Subjekti i dispozitave të paragrafit 4 të këtij Neni kur një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai Shtet tjetër mund të mos vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguara nga kompania, përveç kur këto dividendët i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues ose përderisa zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividendët është efektivisht i lidhur me një Seli të përhershme të vendosur në atë Shtet tjetër; subjekt i tatimit nuk do të jenë as fitimet e pashpërndara të kompanisë edhe nëse dividendët e paguara apo fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht në fitime apo të ardhura të realizuara në atë Shtet tjetër.

## **NENI 11**

### **INTERESI**

1. Interesi i krijuar në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhet një rezidenti të shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohet në atë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, interesi i tillë mund të tatohet edhe në Shtetin Kontraktues ku ai krijon dhe në përputhje me ligjet e këtij Shteti, por, kur pronari përfitues i interesit është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.
3. Pavarësisht nga dipozitat nga paragrafi 2, interesi i rritur për:
  - a) Kosovën dhe i paguar Qeverisë së Turqisë ose Bankës Qendrore të Turqisë do të shkarkohet nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat në Kosovë;
  - b) Turqinë dhe i paguar Qeverisë së Kosovës ose Bankës Qendrore të Kosovës do të shkarkohet nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat në Turqi.
4. Termi "interes" në kuptimin e përdorur në këtë Nen nënkupton të ardhurat shtetërore nga letrat me vlerë, dëftesat e borxhit ose obligacioneve të siguruara ose jo me hipotekim, dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet, dhe kërkesat e borxhit të çdo lloji përfshirë fitime të tjera të asimiluara me të ardhurat nga borxhet sipas ligjit mbi tatime të atij Shteti ku fitimi krijohet.
5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një Selie të përhershme të vendosur aty dhe ushtron shërbime të pavarura personale në tjetrin Shtet përmes një Selie të përhershme dhe kërkesa e borxhit për të cilën paguhet interesi është efektivisht e lidhur me këtë Seli të përhershme. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 ose Nenit 14, varësisht nga rasti.
6. Interesat do të konsiderohet se janë krijuar në një Shtet Kontraktues kur paguesi është një rezident i atij Shteti, nënndarje politike, autoritet lokal ose rezident i Shtetit. Megjithatë, kur një person i cili paguan interesin, qoftë ai rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka një Seli të përhershme në një Shtet Kontraktues në lidhje me të cilën ka lindur borxhi për të cilin paguhet interesi, dhe ky interes mbartet nga ana e kësaj Selie të përhershme, atëherë interesi i tillë do të konsiderohet se është krijuar në Shtetin ku është vendosur Selia e përhershme.

7. Kur për shkak të marrëdhënieve të veçanta midis pagesit dhe pronarit përfitues të interesit ose ndërmjet të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesit, bazuar në kërkesën për borxh për të cilën paguhet, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis pagesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij Neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa tepricë e pagesave do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pas parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

## **NENI 12** **HONORARËT**

1. Honorarët që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatonen në atë Shtet tjetër.
2. Megjithatë, honorarët e tilla mund të tatonen në Shtetin Kontraktues në të cilin kanë lindur dhe zbatohen sipas ligjeve të atij Shteti por nëse pronari përfitues i honorarëve është rezident i një Shteti tjetër Kontraktues tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorarëve.
3. Termi " honorarët" në kuptimin e përdorur në këtë Nen nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin, apo të drejtën e përdorimit, të çdo të drejte autori në letërsi, për punime artistike apo shkencore përfshirë filmat kinematografikë, dhe incizimet për radio dhe televizion, çdo patentë, markë tregtare, projekt apo model, plan, proces apo formulë sekrete apo për informacione lidhur me eksperiencën industriale, tregtare apo shkencore.
4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorarëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin krijohen honorarët, nëpërmjet një Selie të përhershme të vendosur aty, dhe e drejta apo pasuria lidhur me të cilën paguhen honorarët është efektivisht e lidhur me këtë Seli të përhershme. Dispozitat e Nenit 7 ose Nenit 14, varësisht nga rasti, do të gjejnë zbatim.
5. Honorarët do të paraqiten në Shtetin Kontraktues kur pagesi është vet Shteti, nëndarje politike, autoritet lokal ose rezident i atij Shteti. Megjithatë

paguesi i honorarëve, qoftë ai rezident i Shtetit Kontraktues apo jo, ka një Seli të përhershme në Shtetin Kontraktues ose një lidhje me bazë të përhershme është efektivisht i lidhur me pronësinë e cila jep të drejtën e lindjes së honorarëve dhe honorarët të tilla kanë lind nga Seli të përhershme si të tilla ose baza të përhershme, atëherë honorarë të tilla do të lindin në Shtetin ku baza e përhershme ose Selia e përhershme është vendosur.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues dhe midis të dyve dhe personave të tjerë, shumica e honorarëve, duke pas parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e tejkalon shumën që do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij Neni do të zbatohen vetëm ndaj shumës së përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa tepriçë e pagesës do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pas parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje.

### **NENI 13**

#### **FITIMET NGA KAPITALI**

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme referuar në Nenin 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të taten në atë Shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme që bëjnë pjesë në pasuritë biznesore të një Selie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë Selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me ndërmarrjen), mund të taten në këtë Shtet tjetër me qëllim të ushtrimit të shërbimeve personale përfshirë dhe përfitime të tilla nga tjetërsimi të një Selie të tillë ose baze të përhershme në Shtetin tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga Shteti Kontraktues me tjetërsimin e anijeve, aeroplanëve që operojnë në komunikacionin ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin operimit të këtyre mjeteve të transportit (anijeve, aeroplanëve dhe automjeteve rrugore) do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues.

4. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie të ndryshme nga ato të referuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

#### **NENI 14**

#### **SHËRBIMET PERSONALE TË PAVARURA**

1. Fitimi i realizuar nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues dhe në aspektin e shërbimeve profesionale ose të tjera veprimtarive do të taten vetëm në atë Shtet, përveç nëse ka një Seli të përhershme në dispozicion të rregullt në Shtetin tjetër Kontraktues për qëllime të ushtrimit të veprimtarisë së tij. Nëse ka një Seli të tillë, fitimi mund të taten në Shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet bazës fikse. Nëse qëndrimi i tij në Shtetin Kontraktues zgjat më shumë se 183 ditë në çdo 12 muaj ai do të ketë bazën fikse në Shtetin tjetër Kontraktues.

2. Termi 'shërbime profesionale' përfshinë veprimtari të pavarur shkencore, letrare, arsimore ose edukative dhe aktivitete të pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, stomatologëve dhe kontabilistëve.

#### **NENI 15**

#### **TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI**

1. Subjekt i dispozitave të Neneve 16, 18, 19 dhe 20, rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi do të taten vetëm në atë Shtet përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna është ushtruar në këtë mënyrë, këto të ardhura të realizuara në këtë mënyrë mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punësimin e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të taten vetëm në Shtetin e përmendur në fillim nëse:

- a) përfituesi është prezent në Shtetin tjetër për një periudhë apo periudha që në total nuk i kalojnë 183 ditë gjatë çdo periudhë 12 – mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës, dhe
  - b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të, një punëdhënësi që nuk është rezident i Shtetit tjetër, dhe
  - c) shpërblimi nuk ka lindur nga një Seli e përhershme që punëdhënësi ka në Shtetin tjetër.
3. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij Neni, pagesat e kryera lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anije, avioni që operohet në trafikun ndërkombëtar të / nga një ndërmarrje mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin është vendosur.

## **NENI 16**

### **HONORARËT E DREJTORËVE**

Honorarët e drejtorëve apo shpërblime të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozicionin e tij si anëtar i bordit të drejtorëve të një kompanie që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë Shtet tjetër.

## **NENI 17**

### **ARTISTËT DHE SPORTISTËT**

1. Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një argëtues, si artist teatri, kinematografie, radio apo televizioni, ose muzikant apo sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë Shtet tjetër.
2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist apo sportist nga veprimtari të tilla realizohen jo direkt nga artisti apo sportisti por nga një person tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e Neneve



7, 14 dhe 15, mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Fitimi i realizuar nga një zbatimës ose sportist nga veprimtari e ushtruar në Shtetin Kontraktues do të lirohet nga tatimi në atë Shtet nëse vizita në atë Shtet është e mbështetur plotësisht ose pjesërisht nga fonde publike të një Shteti tjetër Kontraktues, nënndarje politike ose autoritet lokal.

## **NENI 18**

### **PENSIONET**

1. Subjekt i dispozitave nga paragrafi 2 i Nenit 19, pensione dhe pagesa të tjera të paguara rezidentit të Shtetit Kontraktues në konsideratë të punësimit të mëparshëm do të taten në atë Shtet.
2. Pensioni vjetor i realizuar dhe në pronësi të një rezidenti individual të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë Shtet. Termi 'pensioni vjetor' në këtë paragraf ka kuptimin e një shume të përcaktuar të paguar periodikisht në kohë të përcaktuar gjatë viteve të përcaktuara ose gjatë gjithë jetës në bazë të detyrimit të pagesave në kthim për konsideratë të plotë dhe adekuate.

## **NENI 19**

### **SHËRBIMET QEVERITARE**

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues, nënndarje politike apo nga një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti, nënndarje apo autoriteti do të taten vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto paga dhe shpërblime të ngjashme do të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet janë kryer në atë Shtet dhe individ është rezident i atij Shteti, i cili:

(i) është nënshkruar në atë Shtet; ose

(ii) nuk bëhet rezident i këtij Shteti vetëm për qëllimin e kryerjes së këtij shërbimi.

2. a) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara nga, apo prej fondeve të krijuara nga, një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje, një individ lidhur me shërbimet e kryera atij Shteti apo nënndarje apo autoriteti lokal mund të taten në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto pensione dhe shpërblime të tjera të ngjashme mund të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse individ është një rezident dhe një nënshtetas i atij Shteti.

3. Dispozitat e Neneve 15, 16, 17 dhe 18 do të aplikohen ndaj rrogave, pagave, pensioneve dhe shpërblimeve të tjera të ngjashme lidhur me shërbimet e kryera në lidhje me një biznes të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo një autoritet lokal atje.

## **NENI 20**

### **MËSUESIT DHE STUDENTËT**

1. Çdo pagesë e marrë nga një student apo një specializant biznesi i cili është ose ishte menjëherë përpara vajtjes në Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në Shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim arsimimi apo trajnimi, për qëllim të jetesës së tij, arsimimit apo trajnimit nuk do të taten në atë Shtet, me kusht që të tilla pagesa lindin nga burime jashtë atij Shteti.

2. Gjithashtu, pagesa e marrë nga një mësues apo instruktor i cili është, ose ka qenë menjëherë përpara vajtjes në Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është prezent në Shtetin e përmendur në fillim, për qëllim ligjërimit në një institucion arsimor të pranuar nga autoritetet kompetente të atij Shteti ose është angazhuar në hulumtim shkencor për periudhë e cila nuk kalon dy vite do të shkarkohet nga tatimet mbi pagesa për shërbime personale të

ligjërimin në Shtetin e përmendur në fillim, me kusht që pagesa të tilla vijnë nga burime jashtë Shtetit të përmendur në fillim.

## **NENI 21** **TË ARDHURAT E TJERA**

1. Zëra të të ardhurave të një Rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk mbulohen nga Nenet e mëparshme të kësaj Marrëveshjeje do të taten vetëm në atë Shtet.
2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, të ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme që përcaktohen në paragrafin 2 të Nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një Selie të përhershme të vendosur aty dhe e drejta apo pasuria lidhur me të cilën janë paguar të ardhurat është efektivisht e lidhur me këtë Seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 dhe Nenit 14.

## **NENI 22** **ELIMINIMI I TATIMIT TË DYFISHTË**

1. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues realizon të ardhura ose zotëron kapital i cili, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të taten në Shtetin tjetër Kontraktues, Shteti do të lejojë zbritje në tatim të atij rezidenti, një shumë baras me tatimin mbi të ardhura të paguara në Shtetin tjetër. Zbritja e tillë nuk duhet, sidoqoftë, ta tejkalojë atë pjesë të tatimit, siç është llogaritur para dhënies së zbritjes, që i atribuohet zërave të tillë të të ardhurave të realizuara në këtë Shtet tjetër.
2. Kur, në përputhje me çdo dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat e realizuara të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues përjashtohet nga tatimi në atë Shtet, Shteti i tillë mundet, megjithatë, gjatë llogaritjes së shumës së tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e këtij rezidenti, të marrë parasysh të ardhurat e përjashtuara.

**NENI 23**  
**MOS-DISKRIMINIMI**

1. Nënshtetaset e një Shteti Kontraktues nuk do t'i nënshtrohen ndonjë tatimi apo kërkesë të lidhur me të që të jenë të ndryshme apo më të rënda se sa tatimet apo kërkesat e lidhura me to të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen nënshtetaset e atij Shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti lidhur me rezidencën.

2. Subjekt i dispozitave të paragrafit 4 të Nenit 10, tatimimi i një Selie të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë Shtet tjetër se sa tatimi i vjelur ndaj ndërmarrjeve të këtij Shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta.

3. Përgjithësisht rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 në Nenit 9, paragrafit 7 të Nenit 11, ose paragrafit 6 të Nenit 12, interesat, honorarët dhe shpërblimet e tjera të paguara nga një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kondita njëjloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të Shtetit të përmendur në fillim.

4. Ndërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është plotësisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në Shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë se sa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të Shtetit të përmendur në fillim.

5. Këto dispozita nuk do të interpretohen si të obligueshme për Shtetin Kontraktues për t'iu dhënë rezidentëve të Shtetit tjetër kontraktues pagesa personale, lehtësime ose zbritje për qëllime të tatimit për shkak të statusit civil ose përgjegjësisë familjare të cilat ia japin rezidentëve të atij Shteti.

6. Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 2, dispozitat e këtij Neni do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji dhe përshkrimi.

## NENI 24

### PROCEDURA E MIRËKUPTIMIT RECIPROK

1. Kur një person konsideron se veprimet e njërit apo të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga rrugëzgjdhjet e siguruar nga legjislacioni i brendshëm i këtyre Shteteve, ai mund t'ia paraqesë rastin e tij autoritetit kompetent të Shtetit Kontraktues rezident i të cilit është ai ose, nëse çështja ka të bëjë me paragrafin 1 të Nenit 23, ai mund t'ia paraqesë atë Shtetit Kontraktues nënshtetas i të cilit është ai. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Marrëveshjes. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk sigurohet nga Marrëveshja.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri tjetrin në mënyrë direkte, duke përfshirë këtu dhe ngritjen e komisioneve të përbashkëta të përbëra nga vetë ata apo përfaqësuesit e tyre, me qëllim të arritjes së marrëveshjeve reciproke, në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

## NENI 25

### SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacione të tilla të nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose administrimin apo zbatimin e ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi të vëna në emër të Shteteve Kontraktuese, nënndarjeve politike të tyre apo autoriteteve

lokale, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga Nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë, sipas paragrafit 1, nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij Shteti dhe do t'i shpalolet vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve të referuara në paragrafin 1, apo mbikëqyrjen e këtyre më lartë. Këta persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ata mund ta shpalojnë informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

3. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktuese detyrimin:

- a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;
- b) të ofrojë informacione që ndalohen sipas ligjeve dhe praktikës normale administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;
- c) të ofrojë informacione që mund të shpalojnë një sekret tregtar, biznesi, industrial, komercial ose sekret profesional apo proces tregtar, ose informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informata kërkohet nga Shteti Kontraktues, në pajtim me këtë Nen Shteti tjetër Kontraktues do t'i përdor mjetet për grumbullimin e informatave për të siguruar informatën e kërkuar edhe pse Shteti tjetër mund të mos ketë nevojë për informatë të tillë për qëllime të tatimeve të tyre. Obligimi i përfshirë në fjalinë "e mëparshme" është subjekt i limitimit të paragrafit 3 por në asnjë rast limitime të tilla nuk do të formohen për të lejuar refuzimin e një Shteti Kontraktues për të siguruar informatën vetëm sepse një informatë e tillë nuk paraqet interesin vendor.

5. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 3 të këtij Neni nuk do të interpretohen t'i lejojnë një Shtet Kontraktues ta refuzojë sigurimin e informatave vetëm sepse informata mbahet nga banka, institucion tjetër financiar, një i nominuar ose

person që vepron në një agjenci ose me kapacitete mirëbesimi ose sepse ndërlidhet me interesat e pronësisë të një personi.

## **NENI 26**

### **ANËTARËT E MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE POSTET KONSULLORE**

Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në privilegjet financiare të anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

## **NENI 27**

### **HYRJA NË FUQI**

1. Secili Shtet Kontraktues duhet të njoftojë Shtetin Kontraktues për plotësimin e procedurave të kërkuara me ligj mbi hyrjen në fuqi të Marrëveshjes. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e letrës së njoftimit.

2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë efekt:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim respektivisht në lidhje me shumën e paguar ose kredituar në apo pas 1 janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin është dhënë njoftimi për hyrjen e Marrëveshjes në fuqi;

b) në lidhje me tatimet tjera respektivisht në lidhje me tatimet e ngarkuara për të çdo viti tatimor që fillon me apo pas 1 janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin është dhënë njoftimi për hyrjen e Marrëveshjes në fuqi.

## **NENI 28**

### **PËRFUNDIMI**

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përfundimin nga njëri Shtet kontraktues. Secili Shtet kontraktues mund të përfundojë Marrëveshjen,

nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke dhënë njoftimin me shkrim të përfundimit, të paktën 6 muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik, dhe fillon pas përfundimit të një periudhe pesë vjeçare nga data në të cilën Marrëveshja ka hyrë në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje do të pushoj së pasuri efekt:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim sa i përket shumës së paguar ose kredituar në fund të vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi; dhe

b) në lidhje me tatimet tjera sa i përket viteve tatimore që fillojnë në fund të vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi.

NË DËSHMI TË KËSAJ, ne të poshtënëshkruarit, duke qenë të autorizuar siç duhet për këtë, kemi nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Prishtinë më 10 shtator, të vitit 2012, në gjuhët Turke, Shqipe dhe Angleze, ku të tre tekstet janë autentike. Në raste divergjencash në tekste, teksti në gjuhën angleze do të mbizotëroj.

**PËR REPUBLIKËN E TURQISË**

**PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**Mehmet ŞİMŞEK**  
Ministër i Financave

**Bedri HAMZA**  
Ministër i Financave



## PROTOKOLL

Në momentin e nënshkimit të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Republikës së Kosovës për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat, të poshtë nënshkruarit kanë rënë dakord në lidhje me dispozitat e mëposhtme, të cilat do të jenë pjesë integrale e Marrëveshjes.

### 1. Referuar Nenit 5, paragrafi 3:

Nënkuptoheq që për të themeluar një Seli të përhershme, për aq kohë sa Kosova të ketë më shumë se një periudhë përjashtimi prej 12 muajsh për një vendpunishte, aktivitete të një projekti të ndërtimit ose instalimit në çdo marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe ndonjë vendi tjetër, ndaj aktiviteteve të ngjashme të cekura në paragrafin 3 të Nenit 5 zbatim do të gjej periudha e përjashtimit prej 18 muajsh.

Nënkuptoheq që autoritetet kompetente të Shteteve kontraktuese do ta përcaktojnë me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të kësaj dispozite.

### 2. Referuar Nenit 10, 11 dhe 12, paragrafët 2:

Nënkuptoheq që autoritetet kompetente të Shteteve kontraktuese do ta përcaktojnë me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të këtyre kufizimeve.

### 3. Referuar Nenin 10, paragrafi 2:

Nënkuptoheq që, në rastin e Kosovës, dividendat e paguara nga një ndërmarrje e cila është rezidente e Kosovës një rezidenti të Turqisë do t'i nënshtrohen një tatimi zero për qind në burim.

### 4. Referuar Nenit 24, paragrafi 2:

Nënkuptoheq që në lidhje me paragrafin 2 të Nenit 24 që tatimpaguesi duhet të kërkojë rimbursimin i cili rezulton nga një marrëveshje e tillë reciproke brenda një periudhe prej një viti pasi që administrata tatimore ta ketë njoftuar tatimpaguesin në lidhje me rezultatet e marrëveshjes reciproke.

**NË DËSHMI TË KËSAJ**, ne të poshtë nënshkruarit, duke qenë të autorizuar siç duhet për këtë, kemi nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në dy kopje në Prishtinë më 10 shtator të vitit 2012, në gjuhët Turke, Shqipe dhe Angleze, ku të tre tekste janë të barazvlefshme. Në raste divergjencash në tekste, teksti në gjuhën angleze do të mbizotëroj.

**PËR REPUBLIKËN E TURQISË**

**PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**Mehmet ŞİMŞEK**  
Ministër i Financave

**Bedri HAMZA**  
Ministër i Financave